



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 11241 Prot.

Tiranë, më 22.10. 2014

**Lënda:** Kthim përgjigje

**Drejtuar:** Qendrës “Res Publica” me seli: Rr. “Nikolla Tupe”, Pall. 4, Shk. 1, Ap 5,  
Tiranë

**Në vëmendje të:** Z. Dorian Matlija  
Drejtor Ekzekutiv

I nderuar Z. Matlija,

Agjencia e Prokurimit Publik (këtu e në vijim APP”) mori në shqyrtim kërkesën tuaj datë 15.10.2014, me objekt: “Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit”.

Sipas kërkesës së mësipërme, kërkohet një kopje e vendimeve që ka marrë APP, referuar vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik (këtu e në vijim KPP”) Nr. **45/14**, **252/14**, **270/14**, **301/14**, **378/14** dhe **323/14**, si dhe cilat janë masat që janë marrë.

Sa më sipër, ju sqarojmë se:

Referuar Vendimit të KPP Nr. **301/14**, APP ka marrë Vendimin Nr. 75, datë 11.07.2014, ndaj autoritetit kontraktor, Bordi i Kullimit Vlorë-Sarandë.

Referuar Vendimit të KPP Nr. **323/14**, APP i ka kthyer përgjigje këtij institucioni nëpërmjet shkresës Nr. 7580/1 Prot., datë 17.07.2014.

Referuar Vendimit të KPP Nr. **270/14**, APP i ka kthyer përgjigje këtij institucioni nëpërmjet shkresës Nr. 6666/1 Prot., datë 30.06.2014.

Referuar Vendimit të KPP Nr. **378/14**, APP i ka kthyer përgjigje këtij institucioni nëpërmjet shkresës Nr. 8212/1 Prot., datë 24.07.2014.

Referuar Vendimit të KPP Nr. **45/14**, APP ka marrë Vendimin Nr. 24, datë 091.04.2014, ndaj autoritetit kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Sha Tiranë.


Referuar kërkesës tuaj për Vendimin Nr. **252/14**, APP ju sqaron se, ky është vendim pezullimi procedure prokurimi dhe si i tillë, nuk ka korespondencë të APP.

Bashkëlidhur Ju vëmë në dispozicion një kopje të vendimeve dhe përgjigjeve të sipërpërmendura të APP.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Eduard Ahmeti**

Handwritten signature in blue ink, appearing to read 'E. Ahmeti' with a date '-14' written below it.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 24 Prot.

Tiranë, më 09.04, 2014

*3045*  
Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Ujësjetllës Kanalizime sha, Tiranë

Në vëmendje të: Z. Fatbardh Islamaj  
Drejtore

Për dijeni: Komisionit të Prokurimit Publik Tiranë

I nderuar Z. Islamaj,

Bashkëlidhur ju dërgojmë Vendimin Nr. 24, datë 09.04.2014 të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Eduard Ahmeti

*Eduard Ahmeti*  
14

Kc

*09.04.2014*

P

*14*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

Nr. 24 Datë 09.04.2014

**Autoriteti kontraktor:** Ujësjellës Kanalizime sha, Tiranë

**Objekti:** Dhënie mase disiplinore

**Baza ligjore:** Neni 13/2/i dhe neni 72/2 i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Agjencia e Prokurimit Publik (këtu e në vijim “APP”), në bazë të nenit 13/2/i dhe nenit 72/2 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar (këtu e në vijim “LPP”) është vënë në lëvizje nga Vendimi Nr. 45/1 Prot., datë 04.03.2014 i Komisionit të Prokurimit Publik (këtu e në vijim “KPP”).

**FAKTE DHE RRETHANA**

KPP ka marrë vendimin Nr. 45/2014, datë 04.03.2014, për procedurën e prokurimit me objekt: **“Kryerja e shërbimit të printimit dhe zarfimit të faturës mujore si dhe listave të abonentëve”**, sipas të cilit, ndër të tjera i është propozuar APP të marrë masa administrative ndaj personave përgjegjës të autoritetit kontraktor Ujësjellës Kanalizime sha, Tiranë (këtu e në vijim “AK”), për shkelje të dispozitave ligjore të prokurimit publik.

Me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë ligjor, APP nëpërmjet shkresës Nr. 3045/1 Prot., datë 12.03.2014, i ka kërkuar autoritetit kontraktor, dërgimin e një informacioni të detajuar mbi pretendimet e ngritura nga KPP, konkretisht, lidhur me afatet e ankimit, publikimin e formularit të njoftimit të fituesit, si dhe emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit.

AK nëpërmjet shkresës Nr. 4084/1 Prot., datë 20.03.2014, i ka kthyer përgjigje APP-së, duke i vënë në dispozicion edhe dokumentacionin përkatës.

Nga dokumentacioni i dërguar nga autoriteti kontraktor, rezulton se, pas fazës së vlerësimit nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, me shkresën Nr. 26 Prot., datë 07.02.2014 është bërë ankim në autoritetin kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit nga shoqëria "Ilar" shpk. Pas shqyrtimit të ankesës, **më datë 10.02.2014 i është kthyer përgjigje shoqërisë ankuese nga AK. Më datë 18.02.2014 titullari i autoritetit kontraktor ka nënshkruar formularin e njoftimit të fituesit dhe po këtë datë, njoftimi i fituesit është hedhur në sistemin e prokurimit elektronik.**

Autoriteti kontraktor pretendon se, operatori ekonomik ankues nuk ka dërguar një kopje me shkrim të ankesës drejtuar KPP, si dhe shkresa për pezullim ka ardhur pranë autoritetit kontraktor datë 21.02.2014, ndërkohë që afati i publikimit të njoftimit të fituesit duhej të ishte data 20.02.2014. Gjithashtu sqarohet se, KPP nuk i ka pranuar ankesat e operatorëve ekonomikë ankues në lidhje me këtë procedurë prokurimi, si dhe AK ndodhet përpara faktit të një gabimi njerëzor në përlllogaritjen e datës së kthimit të përgjigjes operatorit ekonomik "Ilar" shpk, veprim i cili nuk ka shkaktuar pasoja juridike dhe ekonomike.

### ARSYETIMI I APP

Nga analiza e informacionit dhe dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se, në datë 07.02.2014 shoqëria "Ilar" shpk ka depozituar pranë AK ankimin administrativ, në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt **"Kryerja e shërbimit të printimit dhe zarfimit të faturës mujore si dhe listave të abonentëve"**. Në datën 10.02.2014, AK i ka kthyer përgjigje shoqërisë ankuese, me anën e së cilës e ka informuar për refuzimin e ankimit dhe në datën 18.02.2014, titullari i autoritetit kontraktor ka nënshkruar formularin e njoftimit të fituesit:

Në rastin konkret, autoriteti kontraktor ka shkelur nenin 63/3 dhe 63/6 të LPP, ku parashikohet se: **"Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikat 5 dhe 6 të këtij neni.**

*Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankimesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor".*

Referuar dispozites së mësipërme, APP arsyeton se AK duhet të kishte pritur kalimin e afatit të sipërcituar që kishte në dispozicion operatori ekonomik për t'u ankuar në KPP, pastaj të vijonte me publikimin e njoftimit të fituesit.

Për sa i përket kundërshtimit se, operatori ekonomik ankues nuk ka dërguar një kopje me shkrim

të ankesës drejtuar KPP, sqarojmë se, pavarësisht se në nenin 63/6 të LPP parashikohet ndër të tjera se "... Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor", kjo nuk e shkarkon AK nga përgjegjësia për mosrespektimin e afateve të ankimit, pasi në bazë të nenit 63/3 të LPP, AK ka pasur detyrimin ta mbajë procedurën të pezulluar derisa ankesa të shqyrtohej plotësisht, përfshirë edhe shqyrtimin e mundshëm në shkallë të dytë ankimi.

Lidhur me këtë konstatim, APP arsyeton se, **kundërshtimet e bëra nga AK janë të pambështetura në ligj.**

Në pikën 1/c, kreu V, të VKM Nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", me ndryshime, parashikohet se: "*Përveç detyrave të përcaktuara në këto rregulla ose të detyrave të tjera që i ngarkohen, njësia e prokurimit është përgjegjëse për sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e rregjistrit të parashikimit të prokurimeve publike, të rregjistrit të realizimit, për hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për botim brenda afateve kohore, për hartimin e urdhrave të prokurimit...*".

Referuar sa më sipër, përgjegjës për shkeljen e konstatuar janë të gjithë anëtarët e njësisë së prokurimit, të cilët kanë hartuar formularin e njoftimit të fituesit dhe e kanë hedhur në sistemin e prokurimit elektronik në datë 18.02.2014, pra pa respektuar afatin e ankimit në shkallë të dytë.

Në kushtet kur, autoriteti kontraktor ka konsumuar shkeljen e nenit 63 të LPP, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se, sipas vendimit të KPP nuk është pranuar ankesa e operatorit ekonomik ankues dhe është lejuar autoriteti kontraktor të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, APP në mbështetje të neneve 13/2/i dhe 72/2 të LPP,

#### **VENDOS:**


1. T'i propozojë titullarit të autoritetit kontraktor **marrjen e masave disiplinore** ndaj të gjithë anëtarëve të njësisë së prokurimit, konkretisht **Znj. Ariela Nallbani, Znj. Irida Lesha, Znj. Entela Dedo**, për shkelje të dispozitave të prokurimit publik.

2. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Eduard Ahmeti**



*Df. 09.04.2014*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 8212/Prot.

Tiranë, më 24.07, 2014



**Lënda:** Kthim përgjigje

**Drejtuar:** Komisionit të Prokurimit Publik

**Në vëmendje të:** Z. Denar Biba  
Kryetar

I nderuar Z. Biba,

Me Vendimin Nr. 378/2014 Prot, datë 09.07.2014, Komisioni i Prokurimit Publik ka kërkuar nga Agjencia e Prokurimit Publik (këtu e në vijim "APP") marrjen e masave administrative ndaj personave përgjegjës për shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit publik me objekt "Evadim mbetjesh të rrezikshme spitalore", me fond limit 2 000 133 lekë pa TVSH, të zhvilluar në datë 28.05.2014, nga Spitali Universitar "Shefqet Ndروqi", në cilësinë e autoritetit kontraktor.

Në këtë vendim, Komisioni i Prokurimit Publik, pasi ka gjykuar se autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim me Nenin 2 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, (këtu e në vijim "LPP"), në drejtim të kualifikimit të operatorit ekonomik "Medi Tel" Shpk, ka vendosur, ndër të tjera, anulimin e procedurës së prokurimit.

Neni 19/1, pika 2, e LPP përcakton se *Komisioni i Prokurimit Publik, në përfundim të shqyrtimit të ankesave, merr vendime, të cilat janë administrativisht përfundimtare.*

Në bazë të nenit 64/3, pika 1, e LPP, *palët kanë të drejtë që, kundër vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, të bëjnë padi për shqyrtim të mosmarrëveshjes administrative në gjykatën përkatëse.*

Në kuptim të këtyre parashikimeve, Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime në kuadër të procesit të rishikimit, i cili është një mekanizëm që synon parandalimin e pasojave për shkelje të kryera në procedurat e prokurimit publik, nga ana e autoriteteve kontraktore, dhe zbatimin me efektivitet të legjislacionit të prokurimit publik.

Në këtë kuadër, vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik korrigjojnë shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimit, duke mos lejuar ardhjen e pasojave përkatëse, si dhe duke detyruar autoritetet kontraktore, që rast pas rasti, të anullojnë një vendim apo veprim të kryer në kundërshtim me ligjin.

Nga ana tjetër, referuar nenit 13, pika 2/i, të LPP, në rast se evidenton shkelje të dispozitave ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik, të kryera nga autoritetet kontraktore gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, APP merr masat përkatëse administrative, të cilat parashikohen në nenin 72 të LPP.

Në kontekstin dhe frymën e ligjit, APP vlerëson se caktimi i masave administrative synon ndëshkueshmërinë e autoriteteve kontraktore për veprime, apo mosveprime që i kanë sjellë efektet e tyre.

Përsa më sipër, APP vlerëson se nuk mund të marrë masa ndaj autoriteteve kontraktore, për shkelje të konstatuara nga Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të procedurave të rishikimit, të cilat nuk i kanë sjellë pasojat e tyre.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni i Prokurimit Publik ka kompetencën të vendosë masat përkatëse korrigjuese, për të cilat autoritetet kontraktore kanë detyrimin ligjor për t'i zbatuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Eduard Ahmeti**

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Eduard Ahmeti', with a horizontal line drawn through it. The number '14' is written below the signature.

Dt-24.07.2014





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 6666/Prot.

Tiranë, më 30.06.2014

**Lënda:** Kthim përgjigje

**Drejtuar:** Komisionit të Prokurimit Publik

**Në vëmendje të:** Z. Denar Biba  
Kryetar



I nderuar Z. Biba,

Me Vendimin Nr. 270/2014 Prot, datë 30.05.2014, Komisioni i Prokurimit Publik ka kërkuar nga Agjencia e Prokurimit Publik (këtu e në vijim "APP") marrjen e masave administrative ndaj personave përgjegjës për shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit publik me objekt "Blerje karburanti", me fond limit 16 024 000 lekë pa TVSH, të zhvilluar në datë 10.04.2014, nga Bordi i Kullimit Lezhë, në cilësinë e autoritetit kontraktor.

Në këtë vendim, Komisioni i Prokurimit Publik ka konstatuar se autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve, dhe në veçanti me Nenin 2 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, (këtu e në vijim "LPP"), në drejtim të kualifikimit të operatorit ekonomik "A.F.M.A", dhe, ndër të tjera, ka vendosur anulimin e procedurës së prokurimit.

Neni 19/1, pika 2, e LPP përcakton se *Komisioni i Prokurimit Publik, në përfundim të shqyrtimit të ankesave, merr vendime, të cilat janë administrativisht përfundimtare.*

Gjithashtu, në bazë të nenit 64/3, pika 1, e LPP, *palët kanë të drejtë që, kundër vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, të bëjnë padi për shqyrtim të mosmarrëveshjes administrative në gjykatën përkatëse.*

Nga ana tjetër, referuar nenit 13, pika 2/i, të LPP, në rast se evidenton shkelje të dispozitave ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik, të kryera nga autoritetet kontraktore gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, APP merr masat përkatëse administrative, të cilat parashikohen në nenin 72 të LPP.

Në kuptim të këtyre parashikimeve, Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime në kuadër të procesit të rishikimit, i cili është një mekanizëm që synon parandalimin e shkeljeve të kryera në procedurat e prokurimit publik, nga ana e autoriteteve kontraktore, dhe zbatimin me efektivitet të legjislacionit të prokurimit publik.

Në këtë kuadër, vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik korrigjojnë shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimit, duke mos lejuar ardhjen e pasojave përkatëse, dhe duke detyruar autoritetet kontraktore, rast pas rasti, të anulojnë një vendim apo veprim të kryer në kundërshtim me ligjin.

Përsa më sipër, APP nuk mund të marrë masa ndaj autoriteteve kontraktore, për shkelje, të konstatuara nga Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të procedurave të rishikimit, të cilat nuk i kanë sjellë pasojat e tyre. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni i Prokurimit Publik ka kompetencën të vendosë masat përkatëse korrigjuese, të cilat autoritetet kontraktore duhet t'i zbatojnë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,



**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Eduard Ahmeti**

Dt. 30.06.2014



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 7580/Prot.  
/2

Tiranë, më 17.07, 2014

**Lënda:** Kthim përgjigje

**Drejtuar:** Komisionit të Prokurimit Publik

**Në vëmendje të:** Z. Denar Biba  
Kryetar



I nderuar Z. Biba,

Me Vendimin Nr. 323/2014 Prot, datë 19.06.2014, Komisioni i Prokurimit Publik i ka propozuar Agjencisë së Prokurimit Publik (këtu e në vijim "APP") marrjen e masave administrative ndaj personave përgjegjës për shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit publik me objekt "Shërbim i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Bulqizë", me fond limit 1 516 667 lekë pa TVSH, të zhvilluar në datë 15.04.2014, nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Bulqizë, në cilësinë e autoritetit kontraktor.

Në këtë vendim, Komisioni i Prokurimit Publik, pasi ka dalë në përfundimin se autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve në drejtim të rivlerësimit për herë të dytë të procedurës së prokurimit, ka vendosur masat përkatëse korrigjuese.

Neni 19/1, pika 2, e LPP përcakton se *Komisioni i Prokurimit Publik, në përfundim të shqyrtimit të ankesave, merr vendime, të cilat janë administrativisht përfundimtare.*

Në bazë të nenit 64/3, pika 1, e LPP, *palët kanë të drejtë që, kundër vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, të bëjnë padi për shqyrtim të mosmarrëveshjes administrative në gjykatën përkatëse.*

Në kuptim të këtyre parashikimeve, Komisioni i Prokurimit Publik merr vendime në kuadër të procesit të rishikimit, i cili është një mekanizëm që synon parandalimin e pasojave për shkelje të kryera në procedurat e prokurimit publik, nga ana e autoriteteve kontraktore, dhe zbatimin me efektivitet të legjislacionit të prokurimit publik.

Në këtë kuadër, vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik korrigjojnë shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimit, duke mos lejuar ardhjen e pasojave përkatëse, si dhe duke detyruar autoritetet kontraktore, që rast pas rasti, të anullojnë një vendim apo veprim të kryer në kundërshtim me ligjin.

Nga ana tjetër, referuar nenit 13, pika 2/i, të LPP, në rast se evidenton shkelje të dispozitave ligjore dhe nënligjore për prokurimin publik, të kryera nga autoritetet kontraktore gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, APP merr masat përkatëse administrative, të cilat parashikohen në nenin 72 të LPP.

Në kontekstin dhe frymën e ligjit, APP vlerëson se caktimi i masave administrative synon ndëshkueshmërinë e autoriteteve kontraktore për veprime apo mosveprime që i kanë sjellë efektet e tyre.

Përsa më sipër, APP vlerëson se nuk mund të marrë masa ndaj autoriteteve kontraktore, për shkelje të konstatuara nga Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të procedurave të rishikimit, të cilat nuk i kanë sjellë pasojat e tyre.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni i Prokurimit Publik ka kompetencën të vendosë masat përkatëse korrigjuese, për të cilat autoritetet kontraktore kanë detyrimin ligjor për t'i zbatuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Eduard Ahmeti**



A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Eduard Ahmeti' with a stylized flourish and the number '14' written below it.

Dt. 17.07.2014



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 75 Prot.

Tiranë, më 11.07.2014

**Lënda:** Dërgim vendimi

**Drejtuar:** Bordit të Kullimit Vlorë - Sarandë

**Në vëmendje të:** Z. Apostol Qirko  
Drejtor

**Për dijeni:** Komisionit të Prokurimit Publik



I nderuar Z. Qirko,

Bashkëlidhur ju dërgojmë Vendimin Nr. 75, datë 11.07.2014, të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Eduard Ahmeti

11.07.2014



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

Nr. 75 Datë 11.08.2014

**Autoriteti Kontraktor:** Bordi i Kullimit Vlorë - Sarandë

**Objekti:** Dhënie mase

**Baza ligjore:** Nenet 13, pika 2/i dhe 72, pika 2, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar



Agjencia e Prokurimit Publik (këtu e në vijim APP) ka marrë në shqyrtim informacionin e dërguar nga autoriteti kontraktor, Bordi i Kullimit Vlorë - Sarandë, në lidhje me shkelje të konstatuar në Vendimin Nr. 301/2014 Prot, datë 11.06.2014, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit publik me objekt "Ruajtja e objekteve të zyrave dhe magazinave të Bordit të Kullimit Vlorë - Sarandë".

**FAKTE DHE RRETHANA**

Me Vendimin Nr. 301/2014 Prot, datë 11.06.2014, Komisioni i Prokurimit Publik ka kërkuar nga Agjencia e Prokurimit Publik (këtu e në vijim "APP") marrjen e masave administrative ndaj personave përgjegjës për shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit publik me objekt "Ruajtja e objekteve të zyrave dhe magazinave të Bordit të Kullimit Vlorë - Sarandë", fondi limit 1 553 000 lekë pa TVSH, të zhvilluar nga Bordi i Kullimit Vlorë - Sarandë, në cilësinë e autoritetit kontraktor (këtu e në vijim "AK").

Për marrjen e një vendimi të drejtë në mbështetje të Nenit 13, pika 2/i, dhe Nenit 72 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, APP, nëpërmjet shkresës Nr. 7293/1 Prot, datë 25.06.2014, i ka kërkuar AK të dërgojë informacionin përkatës, përse konstatuar, për këtë procedurë prokurimi.

Me shkresën Nr. 192 Prot, datë 08.07.2014, AK ka dërguar informacion, shoqëruar me dokumentacion, në lidhje me procedurën e prokurimit publik të sipërcituar.

Pas shqyrtimit të informacionit dhe dokumentacionit, si më sipër, APP konstaton se procedura e prokurimit publik me objekt "Ruajtja e objekteve të zyrave dhe magazinave të Bordit të Kullimit Vlorë - Sarandë" është zhvilluar nga AK në datë 21.04.2014.

Në datë 25.04.2014 është kryer njoftimi i klasifikimit për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, nga ku rezulton se operatori ekonomik "Iva" Shpk është skualifikuar.

Në datë 28.04.2014 operatori ekonomik i sipërcituar ka paraqitur ankesë pranë AK, për të cilën ky i fundit ka kthyer përgjigje në datë 06.05.2014, duke refuzuar ankimimin.

Në datë 13.05.2014 është hedhur në sistemin elektronik të prokurimeve njoftimi i fituesit për këtë procedurë prokurimi. Ndërsa, në datë 15.05.2014 është nënshkruar kontrata përkatëse.

Ndërkohë, në datë 13.05.2014 operatori ekonomik "Iva" Shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Në Vendimin Nr. 301/2014 Prot, datë 11.06.2014, ndër të tjera, Komisioni i Prokurimit Publik ka dalë në përfundimin se AK ka vepruar në shkelje të Nenit 63 të LPP, pasi duhet të respektoje afatin prej 10 ditë që ligji i njej si të drejtë operatorit ekonomik ankimues për të ushtruar të drejtën e ankimit në shkallë të dytë.

Për këtë shkelje, në vendimin e sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik ka rekomanduar që APP të marrë masa administrative ndaj personave përgjegjës.

### ARSYETIMI I APP

Nga analizimi i fakteve dhe dispozitave përkatëse ligjore, APP arsyeton se AK ka vepruar në kundërshtim me parashikimin e Nenit 63, pika 6, të LPP, duke mos respektuar afatet në lidhje me të drejtën e ankimesit për të paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe duke vazhduar, në kundërshtim me parashikimin ligjor të lartpërmendur, me fazat e tjera të procedurës së prokurimit (publikimi i njoftimit të fituesit dhe lidhja e kontratës).

AK, në informacionin e dërguar, argumenton se nuk i është dërguar një kopje me shkrim e ankesës, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, dhe për pasojë nuk mund të kishte dijeni për ankimin e kryer pranë këtij të fundit. Gjithashtu, AK sqaron se me marrjen dijeni nga operatori ekonomik "Iva" Shpk dhe Komisioni i Prokurimit Publik mbi këtë ankim, përkatësisht në datat 16.05.2014 dhe 19.05.2014, janë kryer pezullimet e mëtejshme për vazhdimin e kontratës.

Në dispozitën e lartpërmendur citohet shprehimisht se "*Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor*".

Gjithashtu, neni 63, pika 3, e LPP, përcakton se *“Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni.*

Në këtë kuptim, procedura e prokurimit qëndron e pezulluar, deri në shqyrtimin përfundimtar të ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Sa më sipër, AK duhet të priste përfundimin e afatit kohor të përmendur sipas shkallëve të ankimit, dhe më pas të vazhdonte me fazat e tjera të procedurës së prokurimit.

Në lidhje me argumentin e dhënë nga AK se nuk i është dërguar një kopje e ankesës, APP sqaron se ky argument nuk gjen mbështetje ligjore. Sipas informacionit të dërguar nga AK, ky i fundit i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik “Iva” Shpk në datën 06.05.2014. Ndërkohë, AK ka marrë dijeni për ankesën e operatorit ekonomik të sipërcituar, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, në datë 16.05.2014. Pra, rezulton se AK ka hedhur në sistem (në datë 13.05.2014) njoftimin e fituesit pa respektuar afatin e ankimit.

Sikurse kemi analizuar më sipër në këtë vendim, AK ka patur detyrimin ligjor që të respektonte afatin 10 ditor, brenda të cilit operatori ekonomik ka patur të drejtë të ushtronte të drejtën e ankimit në shkallë të dytë.

Gjithashtu, nga informacioni dhe dokumentacioni i dërguar nga AK, rezulton se komisioni i vlerësimit të ofertave ka përgatitur raportin përmbledhës në datën 13.05.2014.

Në Kreun V, pika 4/gj, të VKM Nr. 1, datë 10.01.2007, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ndër të tjera, përcaktohet se “Komisioni i vlerësimit pas përfundimit të afateve të ankimit, përgatit një raport përmbledhës dhe ia dërgon, për miratim, titullarit të autoritetit”.*

Referuar këtij parashikimi, raporti përmbledhës duhet të ishte përgatitur pas përfundimit të afateve të ankimit.

Në këto rrethana, në bazë të Nenit 13, pika 2/i, dhe Nenit 72, pika 2, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”, i ndryshuar, patur në konsideratë faktin që nga shkelja e dispozitave ligjore dhe nënligjore ka ardhur si pasojë nënshkrimi i kontratës përkatëse, si dhe vlerën e fondit limit, APP*

#### **VENDOS:**

1. T'i propozojë titullarit të AK marrjen e masave disiplinore ndaj Z. Meme Habazaj, Z. Delo Meçani, dhe Znj. Ëngjëllushe Qorraj, në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit, në procedurën e prokurimit me objekt *“Ruajtja e objekteve të zyrave dhe magazinave të Bordit të Kullimit Vlorë - Sarandë”*, për mosrespektim të afateve të ankimit, të parashikuar në Nenin 63, pika 6, të LPP.

2. T'i propozojë titullarit të AK marrjen e masave disiplinore ndaj Z. Arjan Selimaj, Z. Luan Hoxha, dhe Znj. Adelina Ajdinaj, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave,



në procedurën e prokurimit me objekt "Ruajtja e objekteve të zyrave dhe magazinave të Bordit të Kullimit Vlorë - Sarandë", për mosrespektim të detyrimit të parashikuar në Kreun V, pika 4/gj, të VKM Nr. 1, datë 10.01.2007, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Eduard Ahmeti**



Handwritten signature of Eduard Ahmeti, dated 11.07.2014.

Dt. 11.07.2014





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

Nr. 252/1 Protokolli

Datë 24.02.2014

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Denar Biba	Kryetar
Vilma Kadesha	Anëtar
Denis Martopullo	Anëtar
Muharrem Çakaj	Anëtar
Hektor Muçaj	Anëtar



Në mbledhjen e datës 24.02.2014, me

- Objekt:** 1. Urdhër për pezullim procedure prokurimi  
2. Shqyrtimi në themel.
- Subjekte të interesuar:** Autoriteti kontraktor, Ujësjellës-Kanalizime sh.a  
Lushnje  
Agjencia e Prokurimit Publik  
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Këshilli i Ministrave  
Tiranë  
"Nazeri 2000" sh.p.k  
Rruga Kavajës, Qendra Condor, Kulla H, Ap.27  
Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.1 datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes znj. Vilma Kadesha dhe shqyrtoi informacionin e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues,

Vëren:

✓ Respektimin *prima facie* të kushteve formale.

2. Operatori ekonomik ankimes pretendon skualifikimin e tij të padrejtë nga procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me objekt: “Ruajtja dhe shërbimi i depove dhe arkës së sh.a Ujësjellës-Kanalizime Lushnje me roje private”, me fond limit 3.417.927 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 03.02.2014, nga autoriteti kontraktor, sh.a Ujësjellës-Kanalizime Lushnje.

### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës si dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj

#### Arsyeton:

Ankimi i operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k është *prima facie*, i bazuar.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 64 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe neneve 24 dhe 25 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, **Komisioni i Prokurimit Publik**, njëzëri

#### Vendos

1. Të kalojë për shqyrtim ankesën e paraqitur nga shoqëria “Nazeri 2000” sh.p.k, për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me objekt: “Ruajtja dhe shërbimi i depove dhe arkës së sh.a Ujësjellës-Kanalizime Lushnje me roje private”, me fond limit 3.417.927 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 03.02.2014, nga autoriteti kontraktor, sh.a Ujësjellës -Kanalizime Lushnje.
2. Të urdhërojë pezullimin e procedurës së prokurimit dhe moskryerjen e asnjë veprimi nga autoriteti kontraktor deri në shqyrtimin e ankesës dhe marrjen e vendimit përfundimtar.
3. Autoriteti Kontraktor të dërgojë menjëherë pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave; të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e shoqërisë “Nazeri 2000” sh.p.k; një CD me të gjithë materialet e paraqitura nga shoqëritë pjesëmarrëse, si dhe të jepet informacion i hollësishëm, vërtetuar me dokumentacion, për trajtimin e ankesës.
4. I gjithë informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar, të paraqitet jo më vonë se 2 ditë nga data e marrjes së këtij vendimi dhe të jetë shoqëruar me një Proces-Verbal në të cilin të pasqyrohet emërtimi i dokumentave me numrin e fletëve përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar  
Vilma Kadesha

Anëtar  
Denis Martopullo

Anëtar  
Muharrem Çakaj

Anëtar  
Hektor Muçaj

Kryetar  
Denar Biba

